



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Përkthim gazetaresk

Ngarkesa: Numri i krediteve: 4 (katër); 40 orë mësimore (seminare)

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Bachelor me profil Gjuhë, letërsi e qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore janë:

Studenti merr informacion për llojet dhe karakteristikat e teksteve gazetareske. Analizon dhe përkthen tekstet informativë, reportazhet, etj.

Njihet me vështirësitë dhe teknikat e përkthimit të tekstit: kuptimi, investigimi, mbledhja e informacionit, etj. (comprensión, investigación, transvase de información, amplificación, elisión (omisión). Mësohet të përballojë specifika të tilla si: teksti i gjatë, titulli e nëntitulli, shënjat e pikësimit dhe fokusimi.

Objektivat specifike të lëndës:

1. Njeh teknikat bazë të shkencës së përkthimit.
2. Përdor me shkathtësi dhe shprehet me korrektësi në terminologjinë e fushës.
3. Komenton tekstet në kontekstin e tyre social, historik, gjeografik, etj.
4. Identifikon, familiarizohet, redakton textin e përkthyer.
5. Punon individualisht dhe në grup, debatojnë dhe marrin vendime sëbashku.
6. Vetëvlerësohet, fiton pavarësi si përkthyes.
7. Përkthen tekste dhe studion modele të gatshme duke analizuar.